



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 734 Akti

Nr. 789 Vendimi
Tiranë, më 25.7.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Alma Faskaj	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 24.7.2024, ora 13:30, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Albana Palaj**, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, aktualisht ndihmëse ligjore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8471, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Alma Faskaj, dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore, analizoi provat

shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998”, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Albana Palaj, me detyrë ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe aktualisht ndihmëse ligjore në Gjykatën e Apelit Juridiksioni i Përgjithshëm, Tiranë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 165¹ të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në datën 15.6.2021 zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Valbona Sanxhaktari dhe Pamela Qirko. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Alma Faskaj.

4. Në mbledhjen e parë të trupit gjykues të datës 21.6.2021, me vendimin nr. 1, datë 21.6.2021, u caktua me mirëkuptim kryesuese komisionerja Valbona Sanxhaktari, si dhe u deklarua mospasja e asnjë konflikti interesi nga anëtarët e trupit gjykues. Trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 për të tria kriteret, bazuar në pikën 1 të nenit 4 të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

5. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

6. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

¹ Dispozita kalimtare për ndihmësit ligjorë, këshilltarët e gjyqtarëve dhe inspektorët jomagjistratë: “1. Këshilltari i gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësi ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe në gjykatat administrative, si dhe inspektori në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, që nuk gëzon statusin e gjyqtarit ose prokurorit, janë subjekte të procesit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

7. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike e profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

8. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

9. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja dërgoi raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për pasuritë dhe të ardhurat;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

10. AKSIK-ja (ish-Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin² e mbajtur për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Palaj.

11. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe, në përfundim, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit³. Gjithashtu, Shkolla e Magjistraturës ka dërguar rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit⁴ në kuptim të vlerësimit profesional të kryer, bazuar në nenin 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

12. Në vijim, janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5 e nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

13. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes dhe provat e grumbulluara për të tria kriteret:

² Raport mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 30.10.2017, për subjektin e rivlerësimit Albana Palaj, të deklasifikuar plotësisht (me vendim të KDZH-së nr. ***, datë 24.10.2023).

³ Raport për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Albana Palaj, me nr. *** prot., datë 22.6.2023.

⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 23.5.2018.

vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe kriteri i aftësive profesionale, vlerësoi se ato arrijnë nivelin e provueshmërisë dhe, në vijim, në datën 5.7.2024, me vendimin nr. 2 vendosi: (i) përfundimin e hetimit paraprak për subjektin e rivlerësimit, bazuar në të tria kriteret; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40, 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016. Afati brenda të cilit subjekti mund të ushtrojë të drejtat e tij lidhur me njohjen e dosjes së hetimit, paraqitjen e provave/shpjegimeve të tjera në vijim të rezultateve të hetimit apo paraqitje të kërkesave të tjera, sipas të drejtave që gëzon nga ligji, u caktua data 18.7.2024.

14. Në vijim, paraqiti pranë Komisionit shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, të shoqëruara me dokumentacionin⁵ provues.

15. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 3, datë 17.7.2024, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Albana Palaj, në seancën dëgjimore të datës 24.7.2024, ora 13:30, duke e njoftuar nëpërmjet postës elektronike.

II. SEANCA DËGJIMORE

16. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Albana Palaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 24.7.2024, ora 13:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtare, z. Francesco Ciardi.

17. Subjekti i rivlerësimit, znj. Albana Palaj, u paraqit personalisht në seancën dëgjimore, ku shprehu qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

18. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Znj. Albana Palaj ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur dhe duke dërguar dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

20. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, brenda afatit të kërkuar, duke qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës,

⁵ Shpjegimet në lidhje me rezultatet e hetimit nr. *** prot., datë 18.7.2024.

pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1 Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese⁶ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21.2 Sa më sipër, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, së bashku me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuara pranë Komisionit nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLGJ-ja; (ë) verifikimin e denoncimeve nga publiku; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në Komision apo nëpërmjet postës elektronike, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, Komisioni procedoi me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti.

23. Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, pavarësisht nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, duke verifikuar deklaratën e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Palaj, sipas dokumentacionit të administruar gjatë hetimit.

24. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe në burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

25. Në deklaratën *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI në datën 28.1.2017, pas verifikimit administrativ të kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri dhe likuiditete:

⁶ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”*. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: *“Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”*. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: *“Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”*.

26. Automjet tip “Mercedes Class A170 CDI”, vit prodhimi 2001, me targë *. Burimi i krijimit: Blerë *cash* në Itali, më 20.12.2006. Nuk disponohet dokumenti përkatës, vetëm dokumenti i pronësisë mbi automjetin. Vlera: 5,000 euro. Pjesa takuese: 100%⁷.**

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

26.1 Komisioni hetoi lidhur me pasurinë e deklaruar, nga ku rezultoi se automjeti me targë *** është i regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, përcillet certifikata e pronësisë lëshuar në shtetin italian, në datën 29.7.2015, me pronare znj. Albana Palaj dhe leja e qarkullimit, lëshuar në Itali për këtë automjet në emër të shtetasit L.F. Ky automjet ka hyrë në territorin shqiptar me origjinë shtetin italian prej subjektit të rivlerësimit, në datën 3.7.2015, përmes pikës kufitare të M, me vlerë 1,000 euro + taksa 34,207 lekë.

26.2 Në përfundim ka rezultuar se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ.

26.3 Në lidhje me burimin e krijimit të blerjes së automjetit, nga dokumentacioni i përcjellë prej institucioneve rezultoi se ky automjet ka hyrë në territorin shqiptar nga subjekti i rivlerësimit pas rreth 20 ditëve nga data e marrjes së detyrës si ndihmëse ligjore (fleta doganore në datën 3.7.2015, ndërsa marrja e detyrës në datën 16.6.2015). Ndërsa në deklaratën *Vetting* subjekti deklaroi se është blerë në vitin 2006, duke përcjellë edhe vërtetim në gjuhë të huaj nga shoqëria italiane “***” s.r.l., G di Roma. Në vijim, Komisioni u mbështet në hartimin e analizës financiare të burimit të krijimit të automjetit në deklarimin e saj në deklaratën e pasurisë. Pra, me të ardhurat e përfituara në periudhën 2005 – 2006, pasi nga analiza financiare e periudhave të mëparshme rezultoi me situatë negative deri në vitin 2004. Edhe analiza financiare e hartuar nga Komisioni për periudhën 2005 – 2006 rezultoi me vlerë negative prej -503,277 lekësh⁸.

26.4 Në përfundim, Komisioni konstatoi se kjo pasuri është krijuar përpara marrjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit dhe se ajo ka qenë në pamundësi për kryerjen e pagesës për blerjen e tij me të ardhura të ligjshme, në vlerën -503,277 lekë, për të cilën i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

26.5 Pas përcjelljes së shpjegimeve dhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit sqaron se automjeti i blerë në Itali, në datën 20.12.2006, tek autosalloni “****” s.r.l., në vlerën 5,000 euro, është përdorur kryesisht nga bashkëshorti i saj, por, duke qenë se në vitin 2011 ai vendosi të fillojë aktivitetin e transportit të udhëtarëve Shqipëri – Itali dhe vlera e ofruar për blerjen e tij ishte e ulët (1,000 euro), vendosën ta sjellin edhe automjetin në Shqipëri. Me shpjegimet bashkëlidh edhe pasqyrën e llogarisë së sigurimeve shoqërore (INPS) të përditësuar në datën 13.7.2024 në emër të z. F.E dhe sqaron se në analizën financiare të Komisionit duhet të përfshihen edhe të ardhurat e realizuara pranë shoqërisë “****”, në vitet 2002 – 2003, në vlerën totale 11,652 euro. Gjithashtu, duhet të konsiderohen edhe të ardhurat e saj në emigrim për periudhën 1997 – 2004, të cilat janë vlerësuar prej vetë subjektit në masën 50,000 euro. Me shpjegimet përcjell pasqyrën e llogarisë së sigurimeve shoqërore në emër të subjektit Albana

⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting*, aneksi nr. *** në dosjen ILDKPKI, dokumentet: certifikatë pronësie e mjetit rrugor me karakteristikat e mësipërme dhe pronar shtetasen Albana Palaj, lëshuar në datën 11.8.2015; leja e qarkullimit nr. *** për automjetin tip “Daimler Chrysler A 170 CDI” dhe shtetasen Albana Palaj; policë sigurimi automjeti me datë shitjeje datë 9.9.2016, kopje e vërtetimit në italisht (jo në formën e kërkuar nga ligji), lëshuar në datën 20.12.2006 nga “****” s.r.l., G di Roma, ku kalohet pronësia e këtij automjeti (i identifikuar nga numri i njëjtë i shasisë), znj. Albana Palaj.

⁸ Gjithashtu, u konsiderua edhe mundësia e blerjes së tij me të ardhurat e vitit 2015 deri në datën e hyrjes në territorin shqiptar, datë 3.7.2015, nga e cila rezultoi se subjekti nuk kishte mundësi për blerjen e tij me të ardhura të ligjshme.

Palaj të datës 13.7.2024, ku provohet fitimi i shumës së të ardhurave për periudhën 1997 – 2004 në vlerën totale 8,956.53 euro.

Vlerësimi i trupit gjykues

26.6 Në përfundim, trupi gjykues, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit dhe deklarimeve të subjektit në seancë dëgjimore, konstaton se edhe pas përfshirjes në analizën financiare të vlerave të të ardhurave të provuara me vërtetimet e INSP-së, të përcjella me prapësimet e subjektit, rezultati financiar është negativ. Pra, subjekti vazhdon të jetë me pamundësi financiare në vlerën totale të blerjes së automjetit prej 5,000 euro.

26.7 Megjithatë, trupi gjykues çmon se gjatë hetimit u provua në mënyrë shteruese se ky automjet ishte blerë nga subjekti dhe bashkëshorti në shtetin italian, para marrjes së detyrës prej saj. Duke konsideruar se informaliteti dhe remitancat janë fakt i njohur dhe i pranuar në historinë e zhvillimit të Shqipërisë, por edhe duke vlerësuar faktin se subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës prej saj nuk ka pasur kompetenca vendimmarrjeje, trupi gjykues arrin në konkluzionin se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe të mbështetura në prova.

27. Nr. llogarie pranë Tirana Bank, IBAN * në ALL.** Gjendja e llogarisë në vlerën 91,391.54 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga paga. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

27.1 Nga hetimi konfirmohet se subjekti ka çelur llogari rrjedhëse pranë Tirana Bank në datën 1.3.2005, në të cilën janë transferuar të ardhurat nga paga. Vlera e llogarisë në datën 6.1.2017 ka qenë 91,391.54 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga pagat e transferuara në këtë llogari.

Vlerësimi i trupit gjykues

27.2 Sa më lart, trupi gjykues çmon se nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri, në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

28. Kartë krediti VISA me Tirana Bank (kredi qarkulluese), deri në vlerën 50,000 lekë

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

28.1 Nga hetimi konfirmohet se subjekti ka kartë krediti pranë Tirana Bank, aktive nga viti 2014 deri më 17.3.2021, me limit 50,000 lekë.

Vlerësimi i trupit gjykues

28.2 Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë e në përputhje me dokumentacionin bankar, duke mos konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri, në kuptim të procesit të rivlerësimit.

29. Gjendje cash në banesë, tërhequr pranë Tirana Bank nga llogaria IBAN *, në vlerën 1,000,000 lekë.**

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

29.1 Nga hetimi rezultoi se në datën 13.1.2016 subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga llogaria e saj e pagave pranë Tirana Bank shumën 1,000,000 lekë, ndërsa në datën 29.12.2016 ka tërhequr edhe 1,000,000 lekë të tjerë. Në lidhje me burimin e krijimit të këtyre shumave, rezulton se këto vlera janë krijuar nga transfertat e të ardhurave të pagës së saj të akumuluar gjatë disa viteve.

29.2 Ndërsa nga informacioni i përcjellë nga ILDKPKI-ja⁹ Komisioni informohet se shtetasi F.E në datën 30.12.2016 ka depozituar shumën 1,000,000 lekë në Bankën Kombëtare të Greqisë (aktualisht blerë nga ABI Bank), me nr. llog. ***, e cila rezulton të jetë llogaria në lekë e shoqërisë “****” sh.p.k.

Vlerësimi i trupit gjykues

29.3 Sa më lart, trupi gjykues çmon se gjendja *cash* e kursimeve është krijuar me burime të ligjshme dhe nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri, në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Deklarimi i pasurive të tjera nga personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit në deklaratën *Vetting*

30. Tokë (arë) me sipërfaqe 2,300 m², me adresë njësia administrative B e M, bashkia Shkodër, përfituar sipas ligjit nr. 7501 të vitit 1991 “Për tokën”, si kryetar i familjes bujqësore, me numër akti ***. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

30.1 Subjekti përcjell bashkëlidhur deklaratës *Vetting* kopje të aktit të marrjes së tokës në pronësi, në emër të shtetasit F.RR.E, nr. akti ***135, për sipërfaqe totale 2,300 m², nga të cilat 2,200 m² dhe 100 m² truall.

30.2 Nga hetimi i Komisionit nuk rezultoi informacion i përcjellë nga institucionet për këtë pasuri.

30.3 Në përfundim, Komisioni kërkoi nga subjekti i rivlerësimit të japë shpjegime të shoqëruara me dokumentacion mbi gjendjen aktuale të pasurisë dhe, nëse janë kryer investime mbi pronën, të provohet edhe burimi i ligjshëm i tyre.

30.4 Pas përcjelljes së shpjegimeve dhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit sqaron se nga ana e bashkëshortit të saj nuk është aplikuar pranë ASHK-së për regjistrimin e kësaj prone. Kjo më së shumti e vlerësuar nga ai si një pasuri e njohur me AMTP-në dhe për shkak të vendndodhjes së tij jashtë shtetit. Për të provuar pronësinë mbi këtë pasuri, subjekti i është drejtuar Njesisë Administrative B, Bashkia Shkodër, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 10.7.2024, vërteton se z. F.RR.E, ish-banor i fshatit B e M, Njësia Administrative B, është pajisur me tokë bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501 “Për tokën” 2.2 dynymë. Bashkëlidhur me vërtetimin gjendet edhe fragmenti i hartës së vitit 1995, fshati B e M, z. k. ***, ku pasqyrohet pasuria me nr. ***, sipërfaqe 22,000 m², pronar shtetasin F.RR.E. Subjekti bashkëlidh dhe një foto të pasurisë, në të cilën rezulton se gjendja e saj aktuale është tokë e pazhvilluar, tokë arë, e parrethuar, e mbjellë me misër.

Vlerësimi i trupit gjykues

30.5 Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe të mbështetura në prova.

⁹ Aneksi ***, dosja e ILDKPKI-së.

31. Apartament me sipërfaqe 64 m², blerë me kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.6.1996, certifikuar nga ZVRPP Shkodër, me datë lëshimi 15.10.2002. Vlera: 950,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

31.1 Nga komunikimi me ASHK¹⁰ rezultoi se në emër të shtetasit F.E është e regjistruar pasuria Apartament me nr. pasurie ***, z. k. ***, me sip. 64 m². Ndërsa nga kartela e pasurisë bashkëlidhur rezultoi se apartamenti me sip. 64 m² është fituar nga kontrata e shitjes e datë 1.6.1996 dhe është rivlerësuar në vlerën 3,539,200 lekë në datën 17.7.2012. Bashkëlidhet edhe akti i shitblerjes së pronës së pasurisë së paluajtshme apartament banimi nr. *** rep., nr.***, datë 1.6.1996, me palë shitëse shtetasit B dhe F.K dhe palë blerëse z. F.E, me çmim blerjeje 950,000 lekë. Gjithashtu, nga hetimi i Komisionit rezultoi se me gjeneralitetet F.E identifikohet abonent me kontratë furnizimi me ujë, me nr. ***, në instancën Shkodër, me datë lidhje kontrate 10.9.2003.

31.2 Në lidhje me burimin e ligjshëm rezultoi se pasuria është krijuar përpara se subjekti të merrte detyrën dhe është krijuar/regjistruar në emër të bashkëshortit të saj. Komisioni konstaton se në këtë periudhë (datë 24.5.1995 - 1.6.1996) subjekti ka qenë e punësuar si sekretare gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, por nga dokumentacioni i përcjellë nuk provohen të ardhura të fituara prej saj gjatë kësaj periudhe. Ndërsa bashkëshorti në deklaratën *Vetting* deklaroi se ka qenë në emigracion në shtetin grek, nga i cili ka përfituar shumën neto 2,000,000 lekë, por për të cilën nuk përcjell dokumentacion provues.

31.3 Në përfundim, Komisioni konstatoi se kjo pasuri është krijuar nga bashkëshorti i saj përpara marrjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit dhe përpara lidhjes së martesës ligjore prej tyre. Gjithashtu u konstatua se bashkëshorti ka qenë në pamundësi për kryerjen e pagesës për blerjen e apartamentit me të ardhura të ligjshme, në vlerën e plotë të tij, prej -950,000 lekësh, për të cilën i kërkoi subjektit të japë shpjegime.

31.4 Pas përcjelljes së shpjegimeve dhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit sqaron se bashkëshorti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar se kjo pasuri është blerë nga ana e tij me paratë e fituara në emigracion, kryesisht në shtetin grek, në të cilin ka shkuar në mënyrë ilegale në vitin 1992. Për rreth dy vite ka punuar në bujqësi dhe, në pamundësi për t'u pajisur me dokumentacion qëndrimi, është kthyer në Shqipëri, në vitin 1994, dhe më pas, në fillim të vitit 1996, ka emigruar në Itali, sërish ilegal. Ajo sqaron se blerja e apartamentit përkon me njohjen e tyre (fejesën). Subjekti shpjegon se është në pamundësi objektive për të provuar me akte shkresore të ardhurat e përfituara prej tij në këtë periudhë, por u qëndron deklarimeve të saj se kjo banesë është blerë nga bashkëshorti me të ardhurat e realizuara nga ana e tij në emigracion, në Greqi.

Vlerësimi i trupit gjykues

31.5 Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se gjatë hetimit u provua në mënyrë shteruese se pasuria ishte blerë nga bashkëshorti përpara lidhjes së martesës ligjore me subjektin e rivlerësimit dhe përpara marrjes së detyrës prej saj. Duke konsideruar se informaliteti dhe remitancat janë një fakt i njohur dhe pranuar tashmë në praktikën e tij e të Kolegjit, duke vlerësuar edhe faktin se subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së ushtrimit të

¹⁰ Aneksi ***, dosja e ILDKPKI-së.

detyrës nuk ka pasur kompetenca vendimmarrjeje, trupi gjykues arrin në konkluzionin se shpjegimet e subjektit janë bindëse.

32. Objekt 3 kate, i legalizuar, ndërtuar mbi truall me sip. 1,412 m², ku specifikaisht deklarohet:

a. Tokë me sipërfaqe 1,412 m², blerë sipas aktit të shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.5.2002, certifikuar nga ZVRPP-ja Shkodër, datë lëshimi 21.5.2002. Vlera: 100,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

b. Objekt 3 kate, i legalizuar, me funksion banimi (sip. 380 m²) dhe aktivitet ekonomik, (sip. 223.2 m²), i ngritur mbi pasurinë me numër ***, sip. 1,412 m² (tokë + arë). Objekti i legalizuar dhe certifikuar, realizuar me punonjës të palicencuar (jo firmë ndërtimi, prandaj edhe shpenzimet deklarohen pak a shumë në sajë të shënimeve individuale.) Vlera: 15,000,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

32.1 Sipas dokumentacionit¹¹ bashkëlidhur me deklaratën *Vetting* (kartelë e pasurisë së paluajtshme), rezulton se pasuria nr. *** (tokë + arë) është regjistruar në emër të shtetasit F.E, në regjistrin e pasurive të paluajtshme, në datën 21.4.2002. Gjithashtu, përcillet shkresë informacion mbi pasurinë, me anë të së cilës konfirmohet se shtetasi F.E ka të regjistruar pasurinë: arë + truall, me sipërfaqe 1,412 m², nga të cilat 700 m² janë truall, 365.2 m² janë ndërtesë, ndodhur në z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, me adresë fshati B e S, Shkodër. Përcillet kartelë, certifikatë pasurie, lëshuar në datën 8.9.2015 për pasurinë si më lart dhe leje legalizimi në emër të shtetasit F.E, nr. ***, datë 15.10.2014, për “Godinë e kombinuar 3 kate”, me sipërfaqe banimi 380 m² + 223.2 m² për aktivitet.

32.2 Nga informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë nga ASHK-ja¹², rezulton se pasuria është e regjistruar në pasurinë arë + truall me sip. 1,412 m², nr. pasurie ***, në B e S, Shkodër, nga të cilat 700 m² janë truall dhe 365.2 m² janë ndërtesë. Pasuri e regjistruar sipas kontratës së shitblerjes nr.*** rep., nr. *** kol., datë 18.5.2002, me çmim blerjeje 100,000 lekë nga shtetasi S.T, ts cilës në datën 10.7.2012 i është bërë rivlerësimi në shumën 453,252 lekë. Gjithashtu, rezultoi se shtetasi F.RR.E është vetëdeklarues me formularin nr. ***, datë 17.7.2013, për një ndërtim pa leje në B, Shkodër, me sipërfaqe të përgjithshme të ndërtimit 726 m², sipërfaqe bazë 223 m², 3 kate e kombinuar për banim + për repart pune, sipërfaqe të truallit të ndërtimit pa leje 2,000 m².

32.3 Bashkëlidhet me përgjigjen:

a) Procesverbal konstatimi i Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, qarku Shkodër, datë 29.9.2013, për objektin e kombinuar të deklaruar nga shtetasi F.E, nga i cili konstatohet se sip. e parcelës ndërtimore është 600 m², sip. e bazës 223.2 m², sip. e përgjithshme e ndërtimit 603.2 m², numri i kateve 3, sip. banimi 380 m² dhe sip. për aktivitet social ekonomik 223,2 m².

b) Akt kualifikimi nr. 4551, datë 14.10.2014, për objektin informal, që posedohet nga shtetasi F.RR.E me vetëdeklarimin nr. ***, datë 17.7.2013, ndërtuar në B, z. k. ***. Kartelë pasurie datë 14.10.2014, nr. pasurie ***, z. k. ***, në emër të shtetasit F.E, me vlerë të paguar 10,000 lekë, leje legalizimi nr.***, datë 14.10.2014, godinë e kombinuar 3 kate, sip. kati përdhe 223.2 m², sip. kati I 254.7 m², kati II 125.3 m².

¹¹ Aneksi *** dhe aneksi ***, dosja e ILDKPKI-së.

¹² Aneksi ***, dosja e ILDKPKI-së dhe shkresa e ASHK-së Shkodër nr. *** prot., datë 23.4.2024.

c) Leje legalizimi nr. ***, datë 14.10.2014 dhe vendim nr. ***, datë 15.10.2014, për kualifikimin e për legalizim të objektit informal në posedim të shtetasit F.RR.E me funksion të kombinuar, 3 kate, me adresë B e S, komuna B, në posedim të shtetasit F.E.

d) Mandatpagesa (dy) pranë Credins Bank, datë 15.10.2014, për tarifa shërbimi për legalizim, Shkodër, nga shtetasi F.RR.E. Vlera: 10,000 lekë.

32.4 Në lidhje me burimin e ligjshëm, rezulton se pasuria është krijuar përpara se subjekti të merrte detyrën dhe është krijuar/regjistruar në emër të bashkëshortit të saj.

Për vlerën e objektit të legalizuar, personi i lidhur deklaron se ai është ndërtuar nga punonjës ndërtimi të palicencuar dhe, për këtë arsye, nisur nga shënimet që ka ruajtur, vlerëson se shuma që është shpenzuar për ndërtimin e tij është 15,000,000 lekë.

Ndërsa në pyetësin standard shpjegon: “...*Investimet tona kanë filluar që në vitin 1996, kur është blerë apartamenti në Shkodër dhe, më pas, me blerjen e tokës në njësinë administrative B, mbi të cilën kemi vijuar punimet fillimisht për një objekt pune (sot shërben si garazh për mjetet e punës) dhe mbi të është ngritur banesa jonë private, punime të cilat kanë filluar që pa u kthyer nga Italia...*”. Ndërsa nga fotot e objektit bashkëlidhur me përgjigjen e ASHK-së Shkodër konstatohet se deri në datën e aplikimit për legalizim, datë 17.7.2013, objekti është ende i papërfunduar (ngritur karabinaja dhe muratura e tij).

32.5 Në hartimin e analizës financiare të burimit të krijimit, Komisioni ka konsideruar se:

- a. Ndërtimi i banesës ka nisur pas kthimit në Shqipëri (deklaruar fundviti 2004, pra nga fillimi i vitit 2005), duke qenë në pamundësi të përcaktimit të saktë të kohës së kryerjes të punimeve.
- b. Kostoja e investimit është shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme gjatë periudhës 2005 – 2014, mbështetur në metodologjinë e Komisionit.
- c. Gjithashtu ka përfshirë në analizë vlerën e deklaruar nga subjekti dhe bashkëshorti në deklaratën *Vetting* si kosto investimi prej 15,000,000 lekësh, pasi:
 - Nga hetimi nuk u arrit të përcaktohej saktësisht koha e punimeve dhe ndërtimin e kryer në secilin vit, për të bërë llogaritje të sakta me referencat e EKB-së për çdo vit.
 - Bashkëshorti deklaron se punimet në objekt janë kryer nga punonjës të palicencuar, të cilët kanë kryer punë informale. Sipas metodologjisë së Komisionit, në rastet e ngjashme është aplikuar zbritja e vlerës së TVSH-së, fitimit të parashikuar etj. Duke përdorur këtë mënyrë llogaritjeje, rezulton se vlera e ndërtimit të objektit është rreth vlerës (edhe më e vogël) së deklaruar nga bashkëshorti në deklaratën *Vetting*.
 - Duke iu referuar kostos së ndërtimit nga EKB-ja, rezulton se të dhënat e saj i referohen qytetit të Shkodrës dhe jo zonave rreth saj, kostoja e të cilave mund të jetë e ndryshme nga kostoja e ndërtimit e qytetit të Shkodrës. Objekti 3 kate është ndërtuar në B të S, Shkodër.

Analiza financiare e ndërtimit të objektit është paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela nr. 1

Analiza kumulative 2005 – 2014	Vlerat në lek
PASURI	18,381,302
Automjet “Mercedes Class A170 Cdi”, vit prodhimi 2001, me targë ***. I blerë <i>cash</i> në Itali më 20.12.2006, vlera 5,000 euro.	618,515
Objekt 3 kate i legalizuar, me funksion banimi (sip. 380 m ²) dhe aktivitet ekonomik (sip. 223.2 m ²), i ngritur mbi pasurinë me numër ***, sip. 1,412 m ² . Objekt i legalizuar dhe i certifikuar, realizuar me punonjës të palicencuar (jo firmë ndërtimi, prandaj edhe shpenzimet deklarohen pak a shumë në sajë të shënimeve individuale.) Vlera: 15,000,000 lekë.	15,000,000
Automjet furgon, me targë ***, blerë <i>cash</i> në Itali. Vlera: 8,000 euro.	1,097,360
Kapitali themeltar i shoqërisë “****” sh.p.k.	100,000
Shtesa/pakësim likuiditete në bankë dhe <i>cash</i>	1,565,427
<i>Total likuiditete</i>	4,724,545
TË ARDHURA	20,525,275
Të ardhura nga paga si sekretare gjyqësore	4,968,788
Të ardhura të bashkëshortit prej vitit 1996 nga emigracioni në Itali (për periudhën 1.6.1997 – 13.3.2015, vlera 146,384.4 euro dhe të ardhura nga puna e padokumentuar, vlera rreth 150,000 euro).	14,187,987
Të ardhura nga aktiviteti privat “****” sh.p.k. Vlera: 2,228,603 lekë.	0
Të ardhura nga paga si administrator pranë shoqërisë “****” sh.p.k. dhe tërheqja e dividendit për 1.1.2011 – 31.12.2016. Vlera 2,920,800 lekë + dividendi 225,000 lekë.	1,368,500
SHPENZIME	10,372,936
Shpenzime për legalizimin e objektit	10,000
Shpenzime shkollimi për fëmijët	270,000
Shpenzime udhëtimi	4,391,800
Shpenzime jetike	5,611,136
Analiza dokumentuar	-8,138,964

Për blerjen e tokës mbi të cilën është ndërtuar objekti në vlerën 100,000 lekë, me kontratë të lidhur në datën 21.4.2002, Komisioni ka hartuar analizën e mëposhtme:

Tabela nr. 2

Analiza kumulative 1997 – 21.4.2002	Vlerat në euro
Të ardhura nga paga sipas vërtetimit INPS, F.E	€ 22,433
Të ardhura të subjektit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër	€ 23
Të ardhura sipas listës së pagave Albana Palaj	€ 1,570
Të ardhura total	€ 24,025
Blerja e parcelës së tokës me sip. 1,412 m ²	€ 748
Shpenzime jetike në Itali (minimumi jetik 40%)	€ 53,533
Rezultati financiar	€ -30,256

32.6 Në përfundim, Komisioni konstatoi se kjo pasuri është krijuar para marrjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit dhe kërkoi nga subjekti i rivlerësimit të japë shpjegime të shoqëruara me dokumentacion për pamundësinë financiare prej -8,238,964 lekësh (100,000 lekë blerja e truallit + 8,138,964 lekë ndërtimi i objektit), të rezultuar nga analiza financiare për ndërtimin e objektit 3 kate dhe blerjen e truallit me sip. 1,412 m².

32.7 Pas përcjelljes së shpjegimeve dhe atyre të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit sqaron se: *“...Për sa i përket mundësisë financiare për ndërtimin e këtij objekti, unë jam në pamundësi objektive për të provuar ligjërisht një fakt të tillë, por Komisioni, po të marrë në konsideratë të ardhurat de facto, të realizuara nga ana ime dhe bashkëshorti im në emigracion (e ndërtuar me të ardhurat e realizuara me mundin dhe sakrificën mbi 20-vjeçare në emigracion), kjo pasuri është më se e justifikuar. Dua të sqaroj gjithashtu se vlera prej 15,000,000 lekësh përfshin të gjithë shpenzimin tonë për këtë pasuri në tërësi të saj, që nga mbushja e terrenit për ta ngritur në nivel me rrugën, rrethimin anësor me betonarme të saj, themelet dhe ngritjen e saj në tri kate”.*

Vlerësimi i trupit gjykues

32.8 Trupi gjykues çmon se pasuritë si më lart janë krijuar para marrjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit dhe se, për shkak të kohës së gjatë të krijimit të pasurisë, periudhës së gjatë të krijimit të të ardhurave të përdorura për investimin në pasuri, faktit të njohur të impaktit të remitancaeve nga emigrantët në ekonominë e vendit dhe të të ardhurave informale të përfituara prej tyre gjatë kësaj periudhe, çmon se pamundësia financiare e rezultuar nuk duhet të vlerësohet penalizuese në procesin e rivlerësimit të subjektit, pavarësisht vlerës së saj. Këto fakte do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

33. Tokë (arë) me sipërfaqe 600 m², blerë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.5.2002, certifikuar nga ZVRPP Shkodër, datë lëshimi 20.3.2003. Vlera: 300,000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

33.1 Nga hetimi¹³ rezultoi se kjo pasuri është e regjistruar në pasurinë arë me sip. 600 m², nr. pasurie ***, në B të S, Shkodër. Pasuri e regjistruar sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.3.2003, me çmim blerjeje 300,000 lekë nga shtetasit S.T, H.T, E.T. Rezultoi nga analiza e dokumentacionit se personi i lidhur deklaron në mënyrë të pasaktë ekstremitetet dhe datën e lidhjes së kontratës së shitjes së truallit në deklaratën *Vetting*.

33.2 Në lidhje me burimin e ligjshëm rezulton se pasuria është krijuar/regjistruar në emër të bashkëshortit të saj përpara se subjekti të merrte detyrën. Komisioni konstaton se në këtë periudhë (datë 1.11.1999 – 30.8.2004) subjekti deklaron se ka qenë në emigracion. Komisioni hartoi analizën financiare për blerjen e tokës, për periudhën 1997 – 14.3.2003, nga e cila rezultoi se subjekti ishte në pamundësi financiare për vlerën totale të saj prej 300,000 lekësh.

33.3 Komisioni konstatoi se kjo pasuri është krijuar para marrjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit dhe kërkoi nga subjekti i rivlerësimit të japë shpjegime të shoqëruara me dokumentacion për pamundësinë financiare prej - 300,000 lekësh.

33.4 Subjekti i rivlerësimit, shpjegon gjatë seancës dëgjimore dhe me prapësime se: *“...duke provuar me dokumentacion ligjor të ardhura shtesë për vitin 2002 dhe 2003 në emër të bashkëshortit tim në vlerën 11,652 euro dhe në emrin tim në vlerën 8,956.53 euro provoj mundësinë financiare për ta blerë këtë pasuri dhe pavarësisht këtij fakti, i qëndroj deklarimeve të mia si më sipër që po të merren në konsideratë të ardhurat reale, de facto të realizuara nga ana ime dhe bashkëshorti im në emigracion, kjo pasuri është më se e justifikuar.”*

¹³ Aneksi ***, dosja e ILDKPKI-së dhe shkresë e ASHK-së Shkodër nr. *** prot., datë 23.4.2024.

Vlerësimi i trupit gjykues

33.5 Trupi gjykues, edhe pas përfshirjes në analizën financiare të të ardhurave të provuara me dokumentacion të përcjellë pas dërgimit të rezultateve të hetimit konstaton se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi në vlerën totale të blerjes të pasurisë (-300,000 lekë) me të ardhura të ligjshme¹⁴.

34. Automjet furgon (9+1), tip “Ford”, me targë ***, blerë *cash* në Itali, për përdorim vetjak (*disponoj dokumentacionin e pronësisë, por jo një kontratë shitblerjeje*). Vlera: 8,000 euro. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

34.1 Subjekti bashkëlidh¹⁵ me deklaratën *Vetting* certifikatën e pronësisë së mjetit me targë ***, lëshuar në datën 7.4.2009 nga institucionet italiane. DPSHTRR-ja¹⁶ nuk e konfirmon automjetin në emër të bashkëshortit të subjektit. Ndërsa nga përgjigjja e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit¹⁷ Komisioni informohet se shtetasi F.E ka në pronësi mjetin me targa të huaja italiane, *** dhe, sipas sistemit TIMS, rezulton se ky automjet është përdorur brenda territorit të Shqipërisë nga bashkëshorti i subjektit prej datës 10.4.2009.

34.2 Në lidhje me burimin e krijimit të automjetit rezulton se ky automjet është fituar përpara marrjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit. Analiza financiare e Komisionit për mundësinë e blerjes së tij për periudhën 2006 – 7.4.2009 rezulton me vlerë negative prej -2,364,480 lekësh.

34.3 Komisioni konstatoi se kjo pasuri është krijuar para marrjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit dhe i kërkoi të japë shpjegime të shoqëruara me dokumentacion për pamundësinë financiare prej -8,000 euro.

34.4 Subjekti i rivlerësimit me shpjegimet dhe gjatë seancës dëgjimore sqaron se: *“Në lidhje me këtë pikë, i qëndroj shpjegimeve të mia si më sipër që po të merren në konsideratë të ardhurat reale, de facto, të realizuara nga bashkëshorti im në emigracion, kjo pasuri është më se e justifikuar”*.

Vlerësimi i trupit gjykues

34.5 Trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit dhe faktet e trajtuara më lart në këtë vendim për të ardhurat nga emigracioni të subjektit dhe bashkëshortit të saj do të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.

35. Në deklaratën *Vetting*¹⁸, bashkëshorti i subjektit deklaron: *“Automjetet e mëposhtme janë në funksion të aktivitetit privat, në pronësi dhe/ose të marra me qira, të cilat janë paraqitur më poshtë”*.

¹⁴ Analiza financiare përfundimtare e Komisionit për periudhën kohore 1997 – 14.3.2003 rezulton në vlerën negative prej -28,993 euro. Kjo, pasi në analizën financiare të rezultateve të hetimit ishte përfshirë një pjesë e të ardhurave të subjektit dhe bashkëshortit, edhe pse nuk rezultonin nga vërtetimi i INPS-së, por sepse ishin të provuara nga lista e pagave, e përcjellë bashkëlidhur deklaratës *Vetting* nga subjekti.

¹⁵ Aneksi ***, dosja ILDKPKI.

¹⁶ Shkresë e DPSHTRR-së nr. *** prot., datë 17.8.2021.

¹⁷ Shkresë e DPPSH-së nr. *** prot., datë 9.8.2021.

¹⁸ Shihni aneksin *** - ***, dosja e ILDKPKI-së.

35.1 Autobus tip “Daimler Chrysler”, me targë ***, në pronësi të firmës, blerë në Gjermani (sipas mandatit të NBG Bank)¹⁹. Vlera: 8,200 euro. Pjesa takuese: 100%.

35.2 Autobus tip “Domino”, me targë ***, në pronësi të firmës, blerë në Itali (sipas mandatit të Banca P di Lazio)²⁰. Vlera: 10,000 euro. Pjesa takuese: 100%.

35.3 Autobus tip “Ford”, me targë ***. Me kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.3.2015.

35.4 Autobus tip “Mercedes-Benz Sprinter”, me targë ***. Me kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.9.2015.

35.5 Autobus tip “Mercedes-Benz”, me targë ***. Me kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.12.2016.

35.6 Autobus tip “Setra”, me targë ***. Me kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.7.2016.

35.7 Autobus tip “Mercedes-Benz”, me targë ***. Me kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.1.2016.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

35.8 DPSHTRR-ja²¹ nuk përcjell informacion për këto mjete të transportit rrugor.

35.9 QKB-ja²² informon Komisionin se automjetet e mësipërme kanë qenë të regjistruara në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.

Vlerësimi i trupit gjykues

35.10 Sa më lart, trupi gjykues çmon se nuk u konstatuan problematika në lidhje me këto pasuri, në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

36. Llogari bankare në emër të shtetasit F.E pranë U.Credit Banca-Itali, me IBAN *, në vlerën 500 euro (për shpenzime të ndryshme në Itali aktualisht gjendje).**

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

36.1 Subjekti përcjell bashkëlidhur deklaratës²³ *Vetting* kopje të kartës së debitit UniCredit Banca në emër të shtetasit F.E.

Vlerësimi i trupit gjykues

36.2 Trupi gjykues konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe nuk u konstatuan problematika në lidhje me këto pasuri, në kuadër të procesit të rivlerësimit.

¹⁹ Me “Kërkesë për transferim fondesh brenda dhe jashtë vendit” (pagesë elektronike), datë 26.1.2016, nga NBG Bank Albania sh.a., është urdhëruar nga “****” sh.p.k. pagesa ndaj përfituesit “****”, Gjermani, në shumën 8,200 euro. Aneksi ***, dosja e ILDKPKI-së.

²⁰ Me “Kërkesë për transferim fondesh brenda dhe jashtë vendit” (pagesë elektronike), datë 19.7.2016, nga NBG Bank Albania sh.a. është urdhëruar nga “****” sh.p.k. pagesa ndaj përfituesit “****” s.r.l, Itali, në shumën 10,000 euro. Aneksi *** dhe ***, dosja e ILDKPKI-së.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 17.8.2021, e DPSHTRR-së.

²² Shkresë nr. *** prot., datë 16.8.2021, e QKB-së.

²³ Aneksi ***, dosja e ILDKPKI-së.

37. Llogari bankare personale në emër të shtetasit F.E, pranë NBG Bank Albania me *** (kreditohet çdo muaj me pagën neto dhe teprica e kësaj llogarie sot është në vlerën 63,913 lekë).

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

37.1 Nga hetimi²⁴ u konfirmua se personi i lidhur ka çelur llogari page në datën 18.10.2013 pranë ABI Bank, në të cilën janë transferuar të ardhurat nga paga nga llogaria e shoqërisë “***” sh.p.k. Vlera e llogarisë në datën 6.1.2017 ka qenë 63,912.62 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga pagat e transferuara në këtë llogari.

37.2 Gjithashtu, konfirmohet se shtetasi F.E ka çelur llogari rrjedhëse në datën 9.12.2016 në monedhën lekë (nr. llogarie ***), e cila është mbyllur në datën 26.4.2019, ku gjendja e saj në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting* ishte -1,678 lekë.

Vlerësimi i trupit gjykues

37.3 Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë e në përputhje me dokumentacionin bankar, duke mos konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri, në kuptim të procesit të rivlerësimit.

38. Llogari bankare në emër të shoqërisë “*” sh.p.k., pranë NBG Bank Albania, në lekë me IBAN ***** (për veprime të ndryshme në emër të firmës). Vlera: 152,618 lekë.

39. Llogari në emër të shoqërisë “*” sh.p.k., pranë NBG Bank Albania, në monedhën euro me IBAN ***.** Vlera: 0 (zero) euro.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

39.1 Subjekti përcjell bashkëlidhur deklaratës²⁵ *Vetting* konfirmim bankar nga NBG Bank, e cila konfirmon gjendjen e llogarive të shoqërisë “***” sh.p.k. sipas deklaratës të bashkëshortit të subjektit.

39.2 Komisioni konstatoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë, duke deklaruar asetet e zotëruara nga shoqëria “***” sh.p.k. dhe llogaritë bankare të saj, por nuk deklaroi krijimin e kësaj shoqërie në vitin 2011 dhe burimin e krijimit të kapitalit aksioner prej 100,000 lekësh prej tij, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 dhe ligjit nr. 84/2016.

39.3 Subjekti i rivlerësimit shpjegon gjatë seancës dëgjimore dhe në prapësime se: *“Sqaroj se ky fakt përbën vetëm një gabim njerëzor nga ana e tij (deklarimi i parë, panjohuri për mënyrën e plotësimit të saj) dhe jo për të fshehur këtë pasuri, shoqërinë “***” sh.p.k., me kapital në administrim 100% nga ana e tij. Në këtë deklaratë, në mënyrë të tërthortë, ai ka deklaruar ekzistencën e krijimit të kësaj shoqërie, në momentin kur deklaroi automjetet në pronësi apo të marra me qira në funksion të këtij aktiviteti, si dhe llogaritë bankare në emër të kësaj shoqërie. Ndërsa në lidhje me burimin e kapitalit për krijimin e shoqërisë “***” sh.p.k. në vitin 2011 ato burojnë nga të ardhurat e punës në emigracion.”*

Vlerësimi i trupit gjykues

39.4 Trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit janë shteruese dhe bindëse.

²⁴ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 6.8.2021.

²⁵ Aneksi ***, dosja e ILDKPKI-së.

40. Personi i lidhur R.E (djali i subjektit të rivlerësimit) deklaron në deklaratën *Vetting*: “Një numër llogarie PostePay në postë (për veprime të ndryshme); IBAN: ***. Gjendja: 60 euro.”

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

40.1 Subjekti përcjell bashkëlidhur deklaratës²⁶ *Vetting* kopje të MasterCard të Postepay nr. ***, me IBAN ***.

Vlerësimi i trupit gjykues

40.2 Trupi gjykues konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe nuk u konstatuan problematika në lidhje me këto pasuri, në kuadër të procesit të rivlerësimit.

41. Të ardhurat e deklaruara në *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit

- Sekretare gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në periudhën 24.5.1995 – 31.10.1999. Për një pjesë të periudhës (24.5.1995 – 31.12.1997) s’ka dokumentacion, është djegur në trazirat e vitit 1997 (sipas vërtetimit negativ datë 24.10.2016), si dhe gjatë kësaj periudhe kam marrë leje administrative pa të drejtë page (sipas shënimeve në librezë). Vlera neto: 3,059 lekë.

- Për periudhën 1.11.1999 – 30.8.2004, në emigracion me dokumentacion qëndrimi në shtetin italian. Një pjesë e vogël e punës e dokumentuar sipas listës së pagave, ndërsa pjesa më e madhe e saj është e padekluarar (pjatolarëse, ndihmëskameriere, ndihmëskuzhiniere pranë Agriturismo I, restorant “***”, në V, Romë, Itali), prandaj edhe përshkrimi i të ardhurave për afërsisht është 50,000 euro.

- Për periudhën 27.9.2004 – 31.10.2013, sekretare gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (sipas vërtetimit për pagën bruto dhe neto të lëshuar nga kryetari i degës së buxhetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër). Vlera: 4,288,414 lekë.

- Për periudhën 1.11.2013 – 16.6.2015, sekretare gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër (sipas vërtetimit për pagën bruto dhe neto të lëshuar nga kryetari i degës së Buxhetit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër). Vlera: 1,011,643 lekë.

- Për periudhën 16.6.2015 – 31.12.2016, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër (sipas vërtetimit për pagën bruto dhe neto të lëshuar nga kryetari i degës së buxhetit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.) Vlera: 1,178,857 lekë.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

41.1 Në lidhje me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, bashkëlidhet me deklaratën *Vetting*²⁷ vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila na informon se për periudhën 24.5.1995 – 31.12.1997, gjatë së cilës znj. Albana Palaj ka ushtruar detyrën e sekretares gjyqësore, nuk disponohen të dhëna, pasi dokumentacioni është djegur, ndërsa përcillet vërtetim për pagën neto gjatë periudhës 1.4.1999 – 31.12.2013 si sekretare gjyqësore, me vlerë totale neto 4,291,473 lekë dhe për periudhën 1.11.2013 – 16.6.2015 në vlerën totale 1,011,643 lekë; Vërtetim për të ardhurat nga paga për periudhën 16.6.2015 – 31.12.2016, me vlerë totale neto

²⁶ Aneksi ***, dosja e ILDKPKI-së.

²⁷ Aneksi ***, dosja e ILDKPKI-së.

1,178,857 lekë. Komisioni ka përfshirë në analizën e tij të ardhurat e provuara me vërtetimet e institucioneve punëdhënëse, sa rezultuar nga komunikimi me ISSH-në²⁸ dhe DPT-në²⁹, duke i krahasuar me të ardhurat e transferuara në llogarinë e pagës të subjektit të rivlerësimit pranë Tirana Bank³⁰. Pra, vlera totale e të ardhurave të përfituara dhe përfshira në analizën e Komisionit është 6,481,973 lekë.

Vlerësimi i trupit gjykues

41.2 Trupi gjykues konstatoi se vlerat e të ardhurave të përfituara në Shqipëri përputhen me deklarin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*. Ndërsa në lidhje me të ardhurat e subjektit të përfituara gjatë periudhës në emigracion, janë konsideruar të ardhura të ligjshme vetëm të ardhurat e rezultuara nga lista e pagave dhe nga vërtetimi i pasqyrës së të ardhurave nga sigurimet shoqërore në shtetin italian (INPS), të cilat janë në vlerën totale 8,957 euro.

42. Të ardhurat e deklaruara në deklaratën *Vetting* nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit

- *Për periudhën 1991 – 1994, emigruar pa dokumentacion qëndrimi në Greqi, prandaj dhe fitimi nuk mund të provohet me dokumentacion. Vlera neto: 2,000,000 lekë.*

- *Në vitin 1996, emigruar në Itali dhe, prej datës 28.8.1996 e në vijim, emigrant me dokumentacion të rregullt qëndrimi në Itali (Fitimi sipas punës së deklaruar nga data 1.6.1997 – 13.3.2015, sipas ekstraktit të llogarive të pensioneve të sigurimeve shoqërore (INPS, datë 25.10.2016). Vlera: 146,384.4 euro.*

- *Gjatë kësaj periudhe është kryer punë e padokumentuar (punë të ndryshme në ndërtim, mirëmbajtje etj. dhe ky fitim mund të deklarohet përafërsisht). Vlera: 150,000 euro.*

Vlerësimi i trupit gjykues

42.1 Trupi gjykues konstatoi se subjekti dhe personi i lidhur nuk përcjellin dokumentacion provues për fitimin e të ardhurave të personit të lidhur nga emigracioni në shtetin grek dhe, për këtë arsye, nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhura nga emigracioni në këtë shtet. Gjithashtu, në lidhje me të ardhurat e fituara nga emigracioni në Itali, nga kopja e vërtetimit të lëshuar nga INPS, bashkëlidhur me deklaratën *Vetting*³¹ rezulton se bashkëshorti i subjektit për periudhën 30.11.1997 – 13.3.2015 ka përfituar të ardhura nga punësimi në vlerën totale 146,384 euro, të cilat janë përfshirë në analizën financiare të Komisionit.

Të ardhura të bashkëshortit nga aktiviteti i shoqërisë “*” sh.p.k., deklaruar në *Vetting***

42.2 Në vitin 2011, regjistruar aktiviteti privat “***” sh.p.k., me NIPT ***, me objekt “Transport udhëtarësh dhe mallrash brenda dhe jashtë vendit etj.”. Fitimi i shoqërisë sipas vërtetimit të DRT-së Shkodër. Vlera: 2,228,603 lekë.

42.3 Të ardhura nga paga si administrator i shoqërisë “***” sh.p.k. dhe të ardhurat nga tërheqja e dividendit për periudhën 1.1.2011 – 31.12.2016. Vlera: 2,920,800 lekë + dividendi 225,000 lekë.

²⁸ Shkresa e ISSH-së nr. *** prot., datë 9.8.2021.

²⁹ Shkresa e DPT-së nr. *** prot., datë 18.6.2021 dhe shkresa e DTR-së nr. *** prot., datë 11.8.2021.

³⁰ Shkresa e Tirana Bank nr. *** prot., datë 4.8.2021.

³¹ Aneksi ***, dosja e ILDKPKI-së.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

42.4 Nga hetimi³² i Komisionit rezultoi se shoqëria “****” sh.p.k. është regjistruar në datën 6.1.2011, me NIPT ***, me ortak të vetëm të shoqërisë dhe administrator z. F.E, me kapital themeltar në vlerën 100,000 lekë dhe objekt “Transport udhëtarësh dhe mallrash brenda dhe jashtë vendit etj.” me status aktiv. Gjithashtu, rezultoi se z. F.E ka përfituar të ardhura nga paga si administrator i shoqërisë “****” sh.p.k. prej muajit dhjetor të vitit 2011 në vlerën totale prej 1,946,300 lekësh dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër³³ vërtetoi se shoqëria ka realizuar të ardhurat/fitimin si më poshtë:

Viti	Qarkullimi	Fitimi	Dividendi i tërhequr
2011	-	-	-
2012	2,027,438 lekë	604,519 lekë	250,000 lekë
2013	3,582,336 lekë	685,226 lekë	
2014	3,507,845 lekë	483,093 lekë	
2015	3,283,712 lekë	278,257 lekë	
2016	7,040,853 lekë	1,278,646 lekë	

42.5 Gjithashtu, nga hetimi³⁴, në lidhje me konfliktin e interesit me shoqërinë “****” sh.p.k., nuk rezultoi që kjo shoqëri të ketë qenë palë në procese gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër nga viti 2015 e në vijim.

Vlerësimi i trupit gjykues

42.6 Trupi gjykues çmoi se vlera e të ardhurave, me burim nga shoqëria e transportit “****” sh.p.k., e cila do të bëhet pjesë e analizës financiare, përfshin vlerën e dividendit të shpërndarë dhe të ardhurat nga paga si administrator i shoqërisë së bashkëshortit, në vlerën totale 2,171,300 lekë.

43. Të ardhurat e deklaruara në deklaratën *Vetting* nga z. R.E, djali i subjektit të rivlerësimit

43.1 Aktualisht student, i regjistruar në studimet e nivelit Bachelor 3-vjeçar, Shkenca Sociale në Universitetin A, Romë-Itali, me nr. matrikulli *** (shkolla është falas, vetëm regjistrimi në vlerën 20 euro, viti shkollor). Mbulon shpenzimet personale duke kryer punë të ndryshme (kamerier etj.) të padekluar, prandaj dhe të ardhurat janë relative, që variojnë. Vlera: 700-800 euro/muaj.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

43.2 Subjekti përcjell me deklaratën *Vetting*³⁵ kopje të vërtetimit nga A (në gjuhën italiane), i cili konfirmon se shtetasi R.E është regjistruar në Fakultetin e Sh. S për vitin akademik 2016 – 2017. Ndërsa në lidhje me të ardhurat e përfituara prej tij, gjatë qëndrimit në Itali nuk është përcjellë dokumentacion për përfitimin e tyre.

³² Shkresa e DPT-së nr. *** prot., datë 18.6.2021 dhe shkresa e QKB-së nr. *** prot., datë 16.8.2021.

³³ Aneksi ***, dosja e ILDKPKI-së.

³⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 13.6.2024.

³⁵ Aneksi ***, dosja e ILDKPKI-së.

43.3 Ndërsa në pyetësorin standard shpjegon se: *“Nga marrja e detyrës si ndihmës ligjor kam pasur këto shpenzime arsimi për fëmijët e mi. Për fëmijën tim R.E, i regjistruar në kursin Bachelor 3-vjeçar për Sh. S në Universitetin A, Romë, Itali me nr. matrikulli ***, viti shkollor 2016 – 2017 (ku regjistrimi ka qenë në vlerën 20 euro), shkolla ka qenë pa pagesë, ndërsa për sa i përket shpenzimeve për jetesën në këtë vend, ato janë mbuluar tërësisht nga ai vetë (duke punuar në fundjavë dhe pasdite kur i është ofruar një punë, si kamerier, mirëmbajtës kopshti dhe në ndërtim, si dhe ka qëndruar në dhomën ku ne kemi në përdorim pa asnjë shpërblim në pronësi të shtetasit M.S. Nuk mund të jem e saktë për të ardhurat e tij, mesatarisht mund të jenë në vlerën 700-800 euro/muaj.”*

Vlerësimi i trupit gjykues

43.4 Trupi gjykues vlerësoi se në mungesë të dokumentacionit provues nuk do të përfshihen të ardhura të fituara prej z. R.E në shtetin italian. Ndërsa duke ju referuar informacionit *online*³⁶ nga faqja e Universitetit A rezultoi se shkolla nuk ka pagesa regjistrimi (për shkak të karakterit fetar të saj), prandaj Komisioni nuk ka përfshirë shpenzime shkollimi në analizën financiare.

ANALIZA FINANCIARE (për periudhën qershor 2015 – 2016)

44. Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara, u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën *Vetting*, si dhe në aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

44. Në konkludim të sa më sipër, Komisioni hartoi analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën qershor 2015 – 2016, mbi mundësinë financiare të krijimit të pasurive apo likuiditeteve, e cila për këtë periudhë rezultoi me balancë negative prej -546,547 lekësh. Ndërsa për periudhën përpara marrjes së detyrës 1997 – maj 2015 rezulton me vlerë negative prej -17,443,455 lekësh. Komisioni i kaloi barrën e provës, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 mbi pamundësinë financiare të rezultuar gjatë hetimit.

Vlerësimi i trupit gjykues

44.2 Trupi gjykues çmoi se pas përfshirjes në analizë të të ardhurave të fituara në emigracion nga subjekti dhe bashkëshorti i saj sipas vërtetimeve të përcjella me prapësimet, të cilat janë trajtuar gjerësisht më lart në këtë vendim, analiza financiare para marrjes së detyrës rezulton me vlerë negative -15,444,142 lekë, ndërsa nuk ndryshon për periudhën në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzion për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

45. Në përfundim, në lidhje me rubrikën e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues arrin në përfundimin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk rezultuan problematika, të cilat kanë të bëjnë me deklarin të pamjaftueshëm apo mungesë burimesh të ligjshme të krijimit të tyre, të cilat të jenë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Rezultoi e provuar se pasuritë janë krijuar kohë përpara se subjekti të ushtronte detyrën e ndihmës ligjore dhe me të ardhurat e bashkëshortit të saj. Subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit.

³⁶ https://ange***

ANALIZA FINANCIARE

<i>Përshkrimi</i>	Para marrjes së detyrës 1997-15.06.2015	16.06.2015- 31.12.2015	2016
PASURI	19,070,862	377,863	-1,192,538
Makinë Mercedes, Tip Class A170Cdi, viti i prodhimit 2001, me targa *. I blerë cash në I* më 20.12.2006, vlera 5,000 euro.	618,515		
Tokë (Arë) me sipërfaqe 2,300 m ² , B* e M*, Bashkia Sh*, përfituar sipas ligjit 7501 të vitit 1991 "Për Tokën", si kryetar i familjes bujqësore.			
Apartament me sipërfaqe 64 m ² , blerë me kontratë datë 01.06.1996. Vlera 950,000 lekë			
Tokë me sipërfaqe 1,412 m ² , blerë sipas akt shitblerje datë 18.05.2002. Vlera: 100,000 lekë.	100,000		
Objekt 3 kate i legalizuar, me funksion banimi (sip. 380 m ²) dhe aktivitet ekonomik, (sip. 223.2 m ²) i ngritur mbi pasurinë me numër *, sip. 1,412 m ² (tokë + arë). Objekti i legalizuar dhe certifikuar realizuar me punonjës të palicensuar (jo firmë ndërtimi, prandaj edhe shpenzimet deklarohen pak a shumë në saj të shënimeve individuale.) Vlera: 15,000,000 lekë.	15,000,000		
Tokë (arë) me sipërfaqe 600 m ² , blerë sipas kontratës datë 14.03.2003. Vlera: 300,000 lekë.	300,000		
Automjet furgon (9+1), me targë *, blerë Cash në I*, për përdorim vetjak. Vlera: 8,000 euro.	1,097,360		
Kapitali themeltar i shoqërisë R* T* shpk	100,000		
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë dhe CASH	1,854,987	377,863	-1,192,538
<i>Total likuiditete</i>	<i>1,854,987</i>	<i>2,232,849</i>	<i>1,040,311</i>
DETYRIME	0	0	0
PASURINETO	19,070,862	377,863	-1,192,538
TË ARDHURA të dokumentuara	28,572,413	650,875	1,163,532
Të ardhura nga paga si sekretare gjyqësore	5,303,116		
Të ardhura nga paga si ndihmëse ligjore		416,725	762,132
Të ardhura të subjektit të rivlerësimit nga emigracioni për periudhën 01.11.1999-30.08.2004, vlera 50,000 euro	1,186,102		
Të ardhura të bashkëshortit për periudhën 1991-1994, nga emigracioni në Greqi. Vlera neto 2,000,000 lekë			
Të ardhura të bashkëshortit prej vitit 1996 nga emigracioni në Itali. (Për periudhën 01.06.1997-13.03.2015, vlera 146,384.4 euro dhe të ardhura nga puna e pa dokumentuar, vlera rreth 150,000 euro.)	20,547,445		
Të ardhura nga aktiviteti privat "R* T*" shpk. Vlera 2,228,603 lekë.			
Të ardhura nga paga si administrator pranë shoqërisë "R* T*" shpk dhe tërheqja e dividendit për periudhën 01.01.2011-31.12.2016. Vlera 2,920,800 lekë + dividendi 225,000 lekë.	1,535,750	234,150	401,400
SHPENZIME	24,945,693	819,560	1,631,548
Shpenzime për mobilim e apartamentit	500,000		
Shpenzime për legalizimin e objektit	10,000		
Shpenzime shkollimi për fëmijët	300,000	20,000	52,705
Shpenzime udhëtimi	4,583,169	351,008	638,474
Shpenzime jetike	19,552,524	448,552	940,368
Analiza dokumentuar	-15,444,142	-546,547	724,522

B. KONTROLLI I FIGURËS

46. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në përfundim, ky institucion në datën 31.10.2017 ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës³⁷ për subjektin e rivlerësimit Albana Sh. Palaj, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e ushtrimit të detyrës.

47. Komisioni u ka kërkuar institucioneve ligjzbatuese sipas ligjit për dërgim të informacionit mbi të dhëna shtesë për subjektin e rivlerësimit Albana Sh. Palaj, për sa kohë që raporti mbi kontrollin e figurës ishte deri më 31.10.2017. Nga verifikimet nuk kanë rezultuar të dhëna për hetime të mëtejshme.

48. Komisioni i ka kërkuar AKSIK-së deklasifikimin e raportit për vlerësimin e figurës për subjektin e rivlerësimit Albana Sh. Palaj, i cili në vijim ka përcjellë raportin mbi kontrollin e figurës për këtë subjekt rivlerësimi, të deklasifikuar plotësisht³⁸, duke konstatuar se: (i) formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) për subjektin e rivlerësimit Albana Palaj nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar; (iii) përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës.

49. Gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni nuk konstatoi asnjë problematikë lidhur me pastërtinë e figurës për subjektin e rivlerësimit Albana Sh. Palaj.

Konkluzion për rubrikën e vlerësimit të figurës

50. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e AKSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose që të jetë i përfshirë apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

51. Vlerësimi i aftësive profesionale të ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër kryhet në përputhje me parashikimin e nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar edhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

³⁷ Raporti mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 30.10.2017, për subjektin e rivlerësimit Albana Palaj, i deklasifikuar plotësisht (me vendim të KDZH-së nr. ***, datë 24.10.2023).

³⁸ Përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2023, të AKSIK-së.

52. Në nenin 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “*Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës*”.

53. Lidhur me kriterin e parë vlerësues, relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura, Komisioni i ka kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor informacion mbi vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit për periudhën 16.6.2015 – 8.10.2016.

54. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përcjellë në Komision raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Albana Palaj, me nr. *** prot., datë 22.6.2023, si dhe dokumentacionin shoqërues bashkëlidhur tij.

55. Raporti i përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

56. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëvlerësimit; (ii) 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëvlerësimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (iii) 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

57. Pavarësisht raportit të hartuar nga KLGJ-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me analizimin e tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti dhe pesë dosjeve të shortuara sipas një shorti objektiv. Pas analizimit të tyre, si dhe duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk konstatoi problematika, të cilat lidhen me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit Albana Palaj, në cilësinë e ndihmëses ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE (ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime)

58. Nga verifikimi i kryer rezultoi se pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk disponohen të dhëna nga burimet arkivore mbi etikën e ndihmëses ligjore Albana Palaj. Gjithashtu, sipas të dhënave të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër³⁹, është konfirmuar se për subjektin e rivlerësimit Albana Palaj, në ushtrimin e funksionit të saj si ndihmëse ligjore pranë saj, nga emërimi e në vijim nuk është kryer asnjë shkelje e etikës dhe nuk është dhënë masë disiplinore.

TË DHËNA NGA PROKURORITË

59. Prokuroria e Përgjithshme⁴⁰ ka përcjellë në Komision përgjigjet e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, që konfirmojnë se pranë tyre nuk rezultojnë të ketë procedime penale të mosfilluara/pushuara/pezulluara apo të dërguara për gjykim për subjektin e rivlerësimit, Albana Sh. Palaj.

³⁹ Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër nr. *** prot., datë 24.8.2021.

⁴⁰ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.9.2021, të Prokurorisë së Përgjithshme, në dosjen e hetimit.

60. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar⁴¹ konfirmon se pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale nuk rezulton që të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në emër të shtetases Albana Sh. Palaj.

REZULTATET E TESTIMIT PRANË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

61. Lidhur me kriterin e dytë vlerësues, rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës, pranë Komisionit janë përcjellë⁴² rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, të parashikuara në pikën 4 të nenit 179/b⁴³ të Kushtetutës dhe pikën 2 të nenit 42⁴⁴ të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

62. Në testimin profesional të organizuar në Shkollën e Magjistraturës, sipas listave bashkëlidhur vendimit nr. ***, datë 21.5.2018, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës dhe të shpallura nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Vlerësimit Elektronik (faza e parë) dhe Komisioni i Vlerësimit të Testit Profesional (faza e dytë), rezulton se në fazën e parë të testimit subjekti i rivlerësimit ka fituar 53 (pesëdhjetë e tre) pikë nga 100 (njëqind) pikë maksimale, ndërsa në fazën e dytë të testimit profesional ka fituar 113 (njëqind e trembëdhjetë) pikë, nga 200 (dyqind) pikë maksimale.

63. Bazuar në parashikimet e nenit 165/4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit nuk bën pjesë të subjektet që kanë fituar të paktën 60% të pikëve të testimit të aftësive profesionale, për pasojë nuk është kualifikuar për të ndjekur formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës.

64. Duke qenë se testimi pranë Shkollës së Magjistraturës është në vetvete një nga kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit *ex officio*, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit është vlerësuar në këtë testim me një rezultat nën pragun prej 60% të pikëve, rezultat i cili nuk e ka penguar subjektin e rivlerësimit për vijimin e ushtrimit të detyrës.

DENONCIME/ANKESA

65. Nga verifikimi i regjistrin të denoncimeve nuk rezulton që të jenë depozituar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit ankesa apo denoncime nga publiku për subjektin e rivlerësimit Albana Palaj, në kuptim të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Konkluzion për rubrikën e vlerësimit të aftësive profesionale

66. Bazuar në ligjin nr. 84/2016, duke qenë se dokumentet ligjore të analizuara dhe testimi pranë Shkollës së Magjistraturës së bashku shërbejnë në mënyrë kumulative për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, nga analiza në tërësi e kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në ushtrimin e detyrës, duke shfaqur eficiencë e profesionalizëm të një niveli kualifikues, kërkuar nga parashikimi i nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 për vlerësimin e aftësive profesionale.

⁴¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 18.8.2021, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

⁴² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 23.5.2018.

⁴³ Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*.

⁴⁴ Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, Gjykatës Administrative, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

67. Në përmbushje të parashikimit të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në zbatim të nenit 59, pika 1, shkronja “c”, trupi gjykues e konsideron subjektin e rivlerësimit të aftë në kryerjen e funksionit të ndihmëses ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Albana Palaj, aktualisht ndihmëse ligjore në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 25.7.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Alma FASKAJ
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka